



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered | 03-04-2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SPMST/UK | 3276 | 2023 | 1/5 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.371/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtare, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.371/2023 datës 16.02.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë: fshati Pozhoran Komuna e Vitisë, kundër Vendimit me numër protokollit 02/030/01-481/23 të datës 16.01.2023 të Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Shtërpcës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.371/2023 e datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. **ANULOHET** Vendimi i datës 16.01.2023 i Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtërpcës si dhe **anulohet** Konkursi me numër reference RN00010525 për grupin "Specialistë i Shkencave Natyrore" për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike", në Drejtorin e Inspektoratit në Komunën e Shtërpcës, dhe çdo vendim tjetër që rrjedh nga kjo procedurë pranimit.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Shtërpcës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Komuna e Shtërpcës, i publikuar sipas njoftimit të datës 15.12.2022, për grupin "Specialist i Shkencave Natyrore" për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publik"(Profesional 1), në Drejtorin e Inspektoratit "me numër referencës RN00010525, ndwrsa me datë 16.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 02-030/01-481/23 të datës 16.01.2023 të Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Shtërpcës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 28.02.2023, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtërpcës, ndërsa kjo e fundit me datën 15.03.2023 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi E.A drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 1857/2023 të datës 16.02.2023; Njoftimin e Komunës së Shtërpcës me numër protokollit 02-030/01-307/23 të datës 11.01.2023 ; Njoftimin e Komunës së Shtërpcës me numër protokollit 02-030/01-309/23 të datës 11.03.2023; Vendimin e Komunës së Shtërpcës me numër protokollit 02-030/01-481/23 të datës 16.01.2023; Vendimin e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë më Ref.Nr.6-1910 të datës 11.07.2018; Diplomën e lëshuar nga QAMO "Boro e Ramizi" për ankuesin E.A mbi shkallen e përgatitjes profesionale me numër protokollit 828 të vitit 1988; Diplomë e lëshuar nga "International University" Brcko District Bosnia and Herzegovina për ankuesin E.A me numër 300-S18E të datës 03.02.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta lidhur mes Komunës së Vitisë dhe ankuesit E.A me numër protokollit 02-035/02-797 të datës 03.08.2022; Kontratë mbi veprën lidhur mes ankuesit E.A dhe Komunës së Vitisë me numër protokollit 02-112/13-368 të datës 02.06.2021; Pasqyra e llogarisë së Trustit e ankuesit E.A e periudhës 20.10.2003-06.02.2023; Certifikatë e lëshuar nga D&D për E.A në muajin maj 2022; Certifikatë e E.A e periudhës 13-14-15.12.2019; Certifikatë e E.A me numër 2320/19 e datës 10.09.2019; Certifikatë e E.A e datës 12.09.2018; Kontratë punë për kohë të caktuar/të pacaktuar në mes NPSH "Simpatija"811102706 dhe ankuesit E.A me datë 01.03.2020; Licencë e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për E.A me datë 10.08.2019; Kontratë punë për kohë të caktuar/ të pacaktuar në mes NPSH" Simpatija" dhe ankuesit E.A nga data 15.07.2021 deri më datë 31.12.2021; Raport vjetor i inspektorit të Shërbimeve Publike i dorëzuar me datë 01.09.2022; Certifikatë mbi dënimet penale e ankuesit E.A me datë 06.01.2023; Licencë me numër 01-154/21 e datës 23.06.2021 e lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për E.A; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 2197/2023 e datës 28.02.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 2692/2023 e datës 15.03.2023; Lista e aplikantëve për konkursin me numër reference RN00010525 të shpallur nga Komuna e Shtërpcës; Njoftim me numër protokollit 02-030/07-307/23 i datës 11.01.2023; Njoftim me numër protokollit 02-030/01-309/23 të datës 11.01.2023; Lista e shkurtër e konkursit me numër reference RN0010525 me numër protokollit 02-030/01-518/23 të datës 17.01.2023; Njoftim për kandidatin fitues për konkursin me numër reference RN0010525 me numër protokollit 02-030/01-1341/23 të datës 07.02.2023; Ankesën e E.A

drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtërpcës; Vendim me numër protokoll 02-030/01-481/23 të datës 16.01.2023; Letërnjoftim i A.S; Vërtetim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për A.S me datë 15.09.2022; Vërtetim i lëshuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi për A.S me datë 09.09.2022; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj për A.S me numër 290/22 të datës 12.09.2022; Certifikatë e punësimit e lëshuar nga FINCA me datë 26.09.2022; Vërtetim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për A.S me datë 15.09.2022; Vendim i lëshuar nga Zyra e Kryeministrit për A.S me numër protokoll 040/2017 të datës 29.09.2017; Vërtetim punësimi i lëshuar nga Agjencia për informim dhe privatësi për A.S me datë 09.09.2022; Vendim i lëshuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për A.S; Certifikatë e lëshuar nga "ICCED" me datë 17.11.2006; Certifikatë e lëshuar nga "PCEB" me datë 15.05.2015; Certifikatë e lëshuar nga "European Union Office Kosovo" për A.S; Certifikatë e lëshuar nga "European Union Office Kosovo" për A.S me datë 24.06.2015; Certifikatë e lëshuar nga "European Union Office Kosovo" për A.S me datë 25.06.2015; Certifikatë e lëshuar nga "European Union Office Kosovo" për A.S nga data 31.03-01.04.2015; Certifikatë e datës 26.01.2012 e A.S; Certifikatë e lëshuar nga "FINCA" për A.S në muajin Janar 2008; Certifikatë e datës 13.12.2011 e A.S; Certifikatë e lëshuar nga "PCEB" për A.S me datë 12.05.2015; Letërnjoftim i E.A; Kontratë mbi veprën e lidhur mes ankuesit E.A dhe Komunës së Vitisë me numër protokoll 02-112/17-175 të datës 18.02.2022; Pasqyra e llogarisë së Trustit e periudhës 01.08.2022 deri me 20.04.2022 e ankuesit E.A; Prova shitesë të dërguara me e-mail nga Komuna e Shtërpcës për KPMSHCK-në me datë 20.03.2023; Vendim me numër 0235/2017 i lëshuar nga Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut me datë 28.03.2017; Certifikatë e vlefshmërisë me numër 1211 e datës 03.03.2017 e lëshuar nga Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuar nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut; Certifikatë e datës 28.03.2017; Konkursi i shpallur nga Komuna e Shtërpcës me numër reference RN00010525 të datës 05.12.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së Komuna e Shtërpcës, ka shpallur konkursin sipas njoftimit të datës 15.12.2022, për grupin "Specialistë i Shkencave Natyrore" për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publik"(Profesional 1), në Drejtorin e Inspektoratit "me numër referencës RN00010525, i hapur për aplikim nga data 03.01.2023 deri më datën 10.01.2023, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtërpcës, me Vendimin me numër 02-030/01-309/23 të datës 11.01.2023 në procedurën e verifikimit paraprak ka refuzuar aplikacionin e ankuesit me arsyetimin se ankuesi nuk i plotëson kriteret e konkursit. Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër 02-030/01-309/23 të datës 11.01.2023 lidhur me refuzimin e aplikacionit ka parashtruar ankesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore ndërsa ky i fundit me Vendimin me numër 02-030/01-481/23 të datës 16.01.2023 e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që vendimet e atakuara me ankesë janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores(QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil gjegjësisht ankuesi kërkon të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën, të shfuqizoj vendimet e kundërshtuara me ankesë dhe të detyroj Komunën e Shtërpcës që të anuloj konkursin për pozitën *“Specialist i Shkencave Natyrore”* për pozitën *“Inspektor i Shërbimeve Publik”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se pretendimet e ankuesit janë të qëndrueshme, sepse Komuna e Shtërpcës procedurën e rekrutimit të shpallur sipas konkursit me numër referencë RN00010525, të datës 15.12.2022 për grupin *„Specialist tw Shkencave Natyrore”* për pozitën *“Inspektor i Shërbimeve Publik në Drejtorin e Inspektoratit në Komunën e Shtërpcës*, e ka zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sepse pas administrimit të provave gjegjësisht analizimit tw shpalljes së konkursit me numër reference RN00010525, të datës 15.12.2022 për grupin *„Specialist tw Shkencave Natyrore”* për pozitën *“Inspektor i Shërbimeve Publik”* dhe rrjedhimisht ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme për pranim janë përcaktuar *“Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, Të zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët, Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryere detyrën përkatëse. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”*, ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale janë kërkuar si vijon: *Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor); Kualifikime të posaçme formale: Përvoja e punës e kërkuar : Së paku dy (2)vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës dhe rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se kriteret e veçanta të specifikuara në konkursin në fjalë janë në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht sipas Shtojcës Nr. 2 të kësaj Rregullore për grupin Specialistë të *Shkencave Natyrore”*, e renditur në kodin 13, ku fusha e arsimit e kërkuar është *Biologji, Zoologji, Agrikulturë, Pylltari, Gjeografi, Ekologji dhe Mjedis*, ndërsa sipas konkursit me numër reference RN00010525, të datës 15.12.2022 për grupin *„Specialist tw Shkencave Natyrore”* për pozitën *“Inspektor i Shërbimeve Publik”* fusha e arsimit nuk është përcaktuar fare respektivisht është përcaktuar vetëm: *Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor)*, kështu që mbi këto arsye rrjedhë se Komuna e Shtërpcës kriteret e konkursit i ka përcaktuar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr. 2.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marre parasysh shkeljet procedurale dhe ligjore të theksuara më lartë, konstaton se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve.*



2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton nuundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësimin minimal të komuniteteve dhe të gjinive' dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr. 2.

Bazuar në konstatimet si me lartë, e meqenëse janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale gjatë zhvillimit të kësaj procedure të pranimi, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje procedurale dhe shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedure e paligjshme, kështu që, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr.371/2023,

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Malsore Gashi Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Shtërpcës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Shtërpcës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

